VENDIM
Nr.46, datë 14 .6.2010

MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR ME NIVELIN E HUMBJEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2008

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa f, 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 4,5 dhe 6 të Deklaratës Rregullatore, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.12, datë 3.03.2009, nenit 23 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.06.2010, mbasi analizoi kërkesën e OSSH sh.a. të datës 27.04.2010, dhe rezultatet e monitorimit të kryer nga ERE në zonat e shpërndarjes së OSSH sh.a., dhe relacionin e drejtorive teknike të ERE-s që ka kryer këtë monitorim,

konstatoi se :

-Auditi i humbjeve i kryer nga ADL, nuk arriti të verifikonte dhe të përcaktonte nivelin e humbjeve totale për vitin 2008 në sistemin e shpërndarjes, për shkak të kohës së shkurtër për verifikime dhe pamjaftueshmërinë e dokumentacionit dhe të të dhënave.

-Bordi i Komisionerëve për qëllim të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike për vitin 2010 pranoi nivelin e deklaruar të humbjeve për vitin 2008 në masën e deklaruar nga OSSH (përpara privatizimit) në nivelin 32.74%, duke e lënë të hapur të drejtën për t'u shprehur në kuadër të të dhënave që do të rezultonin e verifikoheshin në vijim.

-Nga monitorimi i kryer nga ERE, lidhur me humbjet në shpërndarje ka elemente të tilla, si vetëkonsumi i OSSH sh.a., mbifaturimeve të ndryshme, efektet e kufizimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, të cilat ndikojnë në nivelin e humbjeve në shpërndarje dhe nuk janë marrë në konsideratë në shifrën e supozuar sipas Deklaratës Rregullatore (pika 4,5).

-Deklarata Rregullatore pika 4.5 paragrafi 7, përcakton se niveli i humbjeve aktuale për vitin 2009 do të pranohet i barabartë me nivelin aktual të vitit 2008 dhe do të jetë plotësisht i transferueshëm në tarifat e DSO (OSSH) në përputhje me mekanizmin e kompensimit të përshkruar në pikën 6 dhe do të shërbejë si nivel fillestar për programin e uljes së humbjeve në periudhat e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Niveli i humbjeve të pranuara për OSSH për vitin 2008, për efekt të vendosjes së objektivave të humbjes për tri periudhat rregullatore (2010 -2014) sipas Deklaratës Rregullatore dhe të llogaritjes së tarifës së shpërndarjes është 33.92 %.

2. Efektet financiare të axhustimit të të ardhurave të kërkuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të reflektohen në tarifat për shoqërinë OSSH sh.a., duke përdorur mekanizimin e kompensimit, siç përcaktohet në Deklaratën Rregullatore.

3.Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta